



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 389/2025
Datë: 25 / 09 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, si dhe në përputhje me nenin 3 të Rregullores MD-nr. 03/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës bazuar në shkresën [REDACTED] të datës 13 tetor 2023 të Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, *konfirmim se K- Investments Group Degë e Shoqërisë së Huaj, zyrë përfaqësimi, me seli në Tiranë, Shqipëri, me nr. unik identifikues [REDACTED] i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit/Shqipëri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [REDACTED] me nr. personal [REDACTED], mund të jetë titullar i të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme për personin e huaj të përcaktuara në Ligjin nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.*
2. Kufizimet ligjore për fitimin e të drejtës pronësore në pronën e paluajtshme sipas legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë për shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilat nuk i përcakton legjislacioni përkatës në Republikën e Kosovës, do të zbatohen edhe për shtetasin shqiptar nga pika 1 e këtij vendimi në Kosovë, në pajtim me parimin e reciprocitetit.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së tij.

A r s y e t i m

K- Investments Group Degë e Shoqërisë së Huaj, zyrë përfaqësimi, me seli në Tiranë, Shqipëri, me nr. unik identifikues [REDACTED] i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit/Shqipëri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [REDACTED] me nr. personal [REDACTED] ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën nr. 04-1554, të datës 23.9.2025 për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë, ka shqyrtuar kërkesën e K- Investments Group për përcaktimin e reciprocitetit për fitimin e të drejtës së pronësore në Republikën e Kosovës dhe shkresat tjera të lëndës të bashkëngjitura dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, dhe në pajtim me nenin 3 të Rregullores MD-nr. 03/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësorisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, ka marrë informacionet përkatëse për fitimin e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në shkresën nr. [REDACTED] të datës 13 tetor 2023 të Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, në të cilën ndër të tjera potencohet se: *"Ligji nuk parashikon dispozita specifike/preferenciale për shtetasit nga Kosova. Të gjithë shtetasit e huaj mund të blejnë pasuri të paluajtshme në Shqipëri (përfshirë tokat bujqësore të cilat mund të merren në përdorim deri në 99 vjet) duke e regjistruar atë direkt në emrin e tyre individual ose në një strukturë, kompani apo partneritet", shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e përcaktuara në Ligjin nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, i cili në nenin 5 (1) ndër të tjera përcakton: "Reciprociteti ekziston kur një shtetas i Republikës së Kosovës ose një person juridik me seli në Kosovë mund të fitojë të drejtën në pronë të paluajtshme në shtetin e shtetasit të hua nën kushte të njëjta nën të cilat shtetasit e huaj mund të fitojnë të drejtën në pronën e paluajtshme në Republikën e Kosovës".*

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Blerim Sallahu



Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- K- Investments Group;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.